



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

BURSA PËR KURSET VERORE TË GJUHËS ÇEKE PËR VITIN 2026

Në kuadër të Programit të Bursave “Shkollat Verore të Studimeve Sllave”, ofron 2 (dy) bursa për pjesëmarrje në kurset verore të gjuhës çeke për studentët (mbi 18 vjeç) dhe mësuesit shqiptarë që kanë njohuri ose studiojnë gjuhën çeke.

Kurset do të mbahen për një periudhë 3-4 javore në 3 nivele (fillesht, i mesëm dhe i avancuar) pranë Universitetit Masaryk në Brno në datat 18 korrik – 15 gusht 2026 dhe pranë Universitetit Charles në Pragë në datat 16 korrik – 13 gusht 2026. Institucionet çeke pranuese mbulojnë tarifat e regjistrimit dhe shkollimit, akomodimin, ushqimin dhe ekskursionet.

Formularët e aplikimit me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohen në Ambasadën e Republikës Çeke në Tiranë, brenda datës 13 mars 2026.

Pjesëmarrja e vetëfinancuar në Shkollat Verore të Studimeve Sllave është gjithashtu e mundur në:

Universiteti e Bohemisë Perëndimore në Pilsen,

Universitetin e Bohemisë Jugore në České Budějovice,

Universitetin Palacký në Olomouc,

Institutin e Gjuhës dhe Studimeve Përgatitore në Poděbrady (Qendra Studimore në Universitetin e Charles në Pragë).

Për informacion më të detajuar, për formularët e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar, ju lutemi referohuni informacionit që gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve të Republikës Çeke në link:

<https://msmt.gov.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies-2026>

Personi i kontaktit për programin “Summer Schools of Slavonic Studies 2026”, në Ambasadën Çeke është Znj. Irena Zizka, irena.zizka@mzv.gov.cz;

DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE DHE PROJEKTEVE